



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:090891

Datë: 30.11.2023

Numri i dokumentit: 04996040

PKR.nr.65/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda, me Kryetaren e trupit gjykues Violeta Husaj Rugova, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Besa Dervishaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit S.I. nga f. V., rr. e “R.” Rajoni ., K. P. për vepër penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda, PP/I.nr.42/2023 të datës 27.06.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prezencë të prokurorit të shtetit Lumturije Vuçetaj, i akuzuari S. I. dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit av. Qendresa Muriqi Mekaj, si dhe përkthyesja gjyqësore Katarina Vuksani, me datë 24.11.2023 mori dhe shpalli si dhe me datë 30.11.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari S. I. nga babai M. dhe nënës I. e gjinisë M. i lindur me datë, në f. V., rr. e “R.” Rajoni ., K. P., ka të kryer shkollën fillore, me profesion Gastronom, , i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, baba i dy fëmijëve, me numër të telefonit ../...-..., i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr., i nacionalitetit boshnjak, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datë 05.04.2023 rreth orës 06:15, në f. V., Rajoni . K.P., i pandehuri pa autorizim posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, substanca të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë (Ligji nr. 02/L-128) dhe atë, sasinë e substancës narkotike të llojit Marihuanë”, në peshë prej 12 gram, në atë mënyrë që, me datë 10.02.2023 pas marrjes së informacionit nga dëshmitari A. K. se nga i pandehuri kishte blerë substancë narkotike e cila i është gjetur dhe sekuestruar nga ana e policisë, përderisa kishte qenë i shoqëruar me dëshmitarin D. H. me çrast sigurohet urdhri nga ana e Gjykatës, ku gjatë kontrollit në shtëpinë e tij, i pandehuri fillimisht me të vërejtur policinë në prezencë të tyre hedh një sasi të substancës narkotike në guacën e WC-së e cila arrihet të tërhiqet nga ana e policisë, gjersa në oborrin e të pandehurit në një veturë jofunksionale po ashtu gjendet “Gjoint”, e të cilat kanë rezultuar të llojit “Marihuanë”, me ç’rast nga ana e policisë sekuestrohet sasia e substancës narkotike e cekur si më lartë si dhe të hollat në shumë prej 265€ të cilat ishin në xhepat e veshjeve të pandehurit.

-Me çka ka kryer veprë penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 7,21 par.2,38,39,40,42, 43,44,69,70,71,72 të KPRK-së, nenit 267 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPRK-së, të akuzuarin: S. I. e;

G J Y K O N

1.Me dënim me gjobë në shumë prej 500€(pesëqind eruo), si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve.

2.Dënimi me burg i cekur si më lartë me pëlqimin e të akuzuarit S. I. i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 2000€ (dymijë euro), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 3 (tre) muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

3.Nëse i akuzuari nuk i paguan dënimet me gjobë që shuma e përgjithshme e tyre është prej 2500€ (dymijë e pesëqind euro) brenda afatit të caktuar si më lartë, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burg duke iu llogaritur një ditë burg për çdo 20 euro të gjobës.

4.Konform nenit 267 par.5 të KPRK-së i konfiskohen

-Substanca narkotike e llojit “Marihuanë”, në peshë neto 12 gram dhe “Gjoint” me substancë të dyshuar narkotike të llojit “Marihuanë me peshë prej 1.1 gram., e cila pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të asgjësohet.

-Një telefon mobil i llojit “Iphone ..”, ngjyrë e zezë, me SIM kartelë “...”, me numër telefoni .../...-... dhe me IMEI të cilat pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të shkatërrohen

-Paratë në shumë prej 265€, të llastuara si më poshtë;

1. Kartëmonedhë 1x50 euro me numër serik U.....;
2. kartëmonedhë 1x50 euro me numër serik S.....;
3. kartëmonedhë 1x50 euro me numër serik U.....;
4. kartëmonedhë 1x50 euro me numër serik R.....;
5. kartëmonedhë 1x50 euro me numër serik Z.....;
6. kartëmonedhë 1x10 euro me numër serik P.....;
7. kartëmonedhë 1x5 euro me numër serik M.....,

Këto të holla pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të kalohen në buxhetin e shtetit.

Këtë urdhër për konfiskim do ta ekzekutoj Agjencia për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar brenda 10 ditëve nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

5.Obligohet i akuzuari S. I. që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50€(pesëdhjetë euro), si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej €(pesëdhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, departamenti për krime të rënda, ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.42/2023 të datës 27.06.2023, ndaj të akuzuarit S.I. nga f. V., rr. e “R.” Rajoni ., K. P. për veprë penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestarë, pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurores së shtetit PP/I.nr.42/2023 të datës 27.06.2023, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit iu ka dhënë mundësia që të deklarohen për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarit për rendësin dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i akuzuari S. I. ka deklaruar se është konsultuar me mbrojtësin e tij dhe se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, vullnetarisht pa ndonjë presion, premtim apo detyrim nga askush.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, meqenëse pranimi është i bazuar edhe në provat të cilat i janë bashkangjitur aktakuzës dhe e ka pranuar në të gjitha fazat e procedurës penale, pajtohet me pranimin e fajësisë, ashtu që i propozon Gjykatës që ta aprovoi.

Mbrojtësja e të akuzuarit S. I. av. Qendresa Muriqi Mekaj ka deklaruar se: pajtohet me pranimin e fajësisë dhe është bërë në konsultim me të dhe unë si mbrojtës jam bindur se pranimi i fajësisë është në favor të mbrojturit tim.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarve vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarve, pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 248 të KPRK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 241 të KPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: Raporti i policit/oficerit M. Sh. #... i datës 05.04.2023, raporti i oficerit A. R. #.... i datës 05.04.2023, deklarata e të pandehurit S. I. e dhënë pranë stacionit policor me dt. 05.04.2023 si dhe deklarata e dhënë pranë kësaj prokurorie me datë 13.06.2023, deklarata e A. K. e dhënë pranë stacionit policor në cilësinë e dëshmitarit me dt. 10.02.2023 për një rast tjetër të evidentuar me nr. policor R-.....-.....-.....-....., Informacionet e personit për të kaluarën kriminale të nxjerrtë nga data-baza policore për të pandehurin S. I., Urdhri i Gjykatës Themelore në Pejë për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm nën shenjën UGJK.nr.50/2023 të datës 04.04.2023, procesverbali mbi kontrollin e shtëpisë, banesës, lokaleve tjera dhe personave i datës 05.04.2023, vërtetimi mbi sekuestrimin e provave apo pasurisë të datës 05.04.2023 të përpiluara nga policia, Urdhri i Gjykatës Themelore në Pejë për aprovim retroaktiv të kërkesës për sekuestrim të përkohshëm nën shenjën UGJK.nr.50/23 i datës 07.04.2023, foto e siguruar nga dëshmitari A. K. të cilat janë dhënë vullnetarisht nga telefoni, fotoalbumi nga vendi i ngjarjes, raporti i analizës së

narkotikëve me nr. R-.....-.....-.....-..... i datës 06.04.2023, Nar-Testi i datës 06.04.2023 së bashku nga foto nga dëshmia D#, Nar-Testi i datës 06.04.2023 së bashku nga foto nga dëshmia D#, Lista e dëshmimeve e datës 05.04.2023, deklarata e dëshmitarit A. K. e dhënë pranë stacionit policor me dt. 25.04.2023 si dhe deklarata e të njëjtit e dhënë pranë kësaj Prokurorie me datë 13.06.2023, deklarata e D. H. e dhënë pranë stacionit policor në cilësinë e të dyshuarit me dt. 10.02.2023 për një rast tjetër të evidentuar me nr. policor R-.....-.....-.....-....., Raporti i ekspertizës së dëshmisë/provës D#-Telefonit mobil i datës 26.05.2023 i përpiluar nga Drejtoria e Teknikës Kriminallistike-Spektori për fotografi, video analizë dhe ekzaminim të IT-së, Njësia për ekzaminimin e Pajisjeve të Teknologjisë së Informacionit dhe deklarata e dëshmitarit D. H. e dhënë pranë kësaj Prokurorie me datë 26.06.2023, andaj gjykata erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e për të cilin është shpallur fajtor.

Prokurorja e shtetit lidhur me rrethanat për dënimin ka deklaruar se: meqenëse i pandehuri e pranoi fajësinë, për veprën penale për të cilën është akuzuar, i propozon Gjykatës që të njëjtën ta shpall fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit dhe ta obligoi në pagesën e shpenzimeve të procedurës penale, mbetet pranë propozimeve për konfiskim të konstatuara në faqe 4 dhe 5 të aktakuzës e po ashtu edhe pranë rrethanave rënduese të konstatuara në faqe 4 pika V, gjersa si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë.

Mbrojtësja e të akuzuarit S. I. av. Qendresa Muriqi Mekaj lidhur me rrethanat për dënimin ka deklaruar se: I propozoj Gjykatës që me rastin e caktimit të dënimit të merr parasysh si rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë që është i vullnetshëm ka qenë bashkëpunues me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit i lutem Gjykatës se i njëjti është mbajtur i familjes baba i dy fëmijëve nuk ka qenë i dënuar më parë, është penduar për veprimet që i ka ndërmarr dhe premton se nuk do ta përsërisë veprën penale, i propozoj Gjykatës që t'ia kthej telefonin i cili është i konfiskuar më parë

I akuzuari S. I. ka deklaruar se: e mbështet fjalën e mbrojtësit të tij nuk do ti përsëris veprat penale kërkon nga Gjykata që t'ia lehtësoi dënimin, dhe në qoftë se Gjykata i shqipton dënim të më shqiptoj dënim me gjobë, e sa i përket telefonit le ta vlerëson vet Gjykata.

Gjykata pasi ka dëgjuar palët lidhur me rrethanat për dënimin i ka vlerësuar të njëjtat konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, rrethana këto që ndikojnë në llojin e dënimit. Nga rrethanat lehtësuese vlerësoj se e kanë pranuar fajësinë qysh në fillim, për gjykatën nuk ka të dhëna se i njëjti ka ra ndesh me ligjin më parë, baba i dy fëmijëve. Nga rrethanat rënduese për të akuzuarin e lartcekur gjykata nuk ka gjete asgjë. Ndërsa shkalla e lartë e dashjes e cekur nga ana prokurorisë në aktakuzë nuk është arsyetuar, prandaj gjykata nuk e vlerësoj si rrethanë rënduese.

Gjykata të akuzuarit i ka zbut dënimin nën minimumin e paraparë ligjorë me dispozitën e nenit 267 par. 1 të KPRK-së, marrë parasysh pranimin e fajësisë dhe pendimin e shprehur nga i akuzuari para gjykatës të cilat gjykata i mori si rrethana veçanërisht lehtësuese, bazuar në dispozitën e nenit 71 dhe 72 të KPRK-së.

Me pëlqimin e të akuzuarit pas shpallje së aktgjykimit gjykata dënimin me burg i ka zëvendësuar në dënim me gjobë bazuar 44 të KPRK-së i ka zëvendësuar dënimin me burg në dënim me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë

penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KRPK-së.

Konform nenit 269 par.1 të KRPK-së e lidhur me nenin 270 dhe 276 të KPPRK-së konfiskohen dhe atë Një telefon mobil i llojit “Iphone ..”, ngjyrë e zezë, me SIM kartelë “...”, me numër telefoni .../...-... dhe me IMEI si mjetë të përdorura në kryerjen e veprës penale. Ndërsa shumën e të hollave si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjykata e konfiskoi përfundimisht pasi që janë të holla pasuri-të përfituara nga vepra penale. Të gjitha këto janë sekuestruara në bazë të urdhrit ndalues përfundimtar me nr.UGJK.nr.37/23 të dt.04.05.2023.

Duke u bazuar në nenin 449 dhe 450 të KPPRK-së, e obligoi të akuzuarin e lartcekur që ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit e obligoi të akuzuarin që të paguaj taksen e caktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi..

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 364 të KPPK-Së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,**

2023:090891, 30.11.2023

Kryetarja e trupit gjykues

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.